



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, DATË, ____/____/202__

PËR

**MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 3,061,841 LEKË, PËR FAMILJET
QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 492/1 prot. datë 25.02.2025 me kodin e produktit: “*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme*” - kodi i produktit **91707AB** dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 3,061,841 (tremilion e gjashtëdhjetë e njëmijë e tetëqind e dyzetë e një) lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas tabelës së më poshtëme:

Nr	Emër Mbiemër	Njësia Administrative	Data e kërkesës	Shkaku i fatkeqesise sipas --VKM-së 329, datë 16.5.2012,- ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"	Preventivi per orendit/sendet llogaritur nga KQD	Preventivi per materiale ndertimi llogaritur nga KQD, ne masen 50 % sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012,	Vlera e dëmit totale perfitues
1	Sabri Murrizi	Nr.4	19.04.2024	Zjarri	694,000	-	694,000
2	Brunilda Bektashi	Nr.3	06.09.2024	Zjarri	547,000	147,834	694,834
3	Ibrahim Jaupaj	Nr.4	07.01.2025	Zjarri	513,000	21,794	534,794
4	Lavdrim Kica	Sukth	04.04.2025	Zjarri	148,549	131,831	280,380
5	Ervis Mehmeti	Nr.6	07.04.2025	Zjarri	280,454	73,475	353,929
6	Dashamir Boshnjaku	Katund I RI	28.05.2025	Zjarri	356,666	147,238	503,904
Total							3,061,841

- Ky fond do të merret nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit, për mbrojtjen civile, i akorduar me kodin e produktit: 91707AB, "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".
- Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Sherbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor
Alceida Rroshi



DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtor

Valbona Qirjako




DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Drejtor
Ardian Hjaxaj



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
DREJTORIA E BUXHETIT

"RELACION

PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 3,061,841 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE".

1. Baza Ligjore

- Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile".
- Vkm nr. 329 datë 16. 05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".
- Vkm-së 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", dhe VKM-së nr. 290, datë 17.05.2023, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

2. Relatimi i çështjes

Të nderuar këshilltarë !

Në vijim të procedurave për shkak të rënies së zjarrit në periudha të ndryshme kohore dhe dëmtimit të banesave të qytetarëve banor të Bashkisë Durrës, lëvroj në favor të banorëve të prekur ndihmë financiare. Si mëposhtë parashtrijmë argumentet ligjore të akteve që parashikojnë këto situata.

1. Sipas ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"

Bazuar në ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen Civile" neni 41, pika 2 "Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile."

...në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitin pasardhës, deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara.” pika 4 “Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8 % të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja”.

Ndërkoh në nenin 65 pika 1 thuhet se:

“Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.”,

po kështu edhe në pikën 2 thuhet se: “Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë”:

a) nga të ardhurat e veta vendore;

b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet;

c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

neni 30, pika “gj” ku thuhet se:

“Bashkitë kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre”.

2. Sipas VKM-në 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.”

Ky akt, parashikon qartë dy situatat e fatkeqësive që shkaktojnë dëmet në objekte dhe pasuri të cilët shteti ndihmon financiarisht të dëmtuarit në rastet kur, si rezultat i fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kanë pësuar dëme në njerëz dhe dëme material, në kushtet kur për përballimin e situatës është shpallur gjendja e emergjencave civile apo në gjendjen normale të saj. Të gjitha praktikët e dokumentacionit tekniko-ligjor janë hartuar nga secila Njësi Administrative sipas kompetencave të deleguara, në të cilët ka ndodhur fatkeqësia e rënies së zjarrit, përmytjes duke u mbështetur mbi VKM-në 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.”

Vlerësimi i dëmeve në banesat e qytetarëve të dëmtuar është kryer nga ana Këshillit të Qarkut Durrës, referuar kreut III, nenit 1, pika “e” ku theksohet: “Sipas rastit, me kërkesë të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, këshilli i qarkut përkatës krijon komisionin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit, i cili pas vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën “ç” të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, përcakton masën e dëmshpërblimit për familjet e dëmtuara.”. Për të gjitha rastet e dëmtimeve, është kërkuar shkresërisht që Këshilli i Qarkut Durrës të shprehët për mundësinë e tij financiare për akordimin e ndihmës

... në favor të dëmtuarve, por për mungesë fondesh nuk është lëvruar asnjë vlerë. Masa e ndihmës financiare për dëmtime e banesave nga fatkeqësi të ndryshme natyrore, mbulohet nga programi "Emergjencat Civile" të institucionit të qeverisjes vendore parashikohet qartë në VKM-së 329, datë 16.05.2012, në pikën "f". "Fondet për dhënie e ndihmës akordohen nga buxheti i njësisë të qeverisjes vendore, nga programi "Emergjencat civile". Ngelet në gjykimin tuaj miratimi i procedurës së ndjekur dhe trajtimi financiar sipas këtij relacioni.

Përfitimi financiar i shtetasëve të dëmtuar është si mëposhtë:

- a. ***Dëmet e shkaktuara në orëndi, sende apo elektroshtëpiake do të kompensohen në masën 100 % të vlerës së llogaritur sipas preventivave të përgatitura nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.***
- b. ***Ndërkoh dëmet e shkaktuara në materiale ndërtimore, do të kompensohen në masën 50 % të vlerës së preventivit, kjo e bazuar në kreun III, nenit 3, pika "ç" Masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale ose në grupe të vogla të banesave jepet nga Ministria e Brendshme ose njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet fondit të miratuar në buxhetin e vitit në programin "Emergjencat civile". Ajo do të llogaritet në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në shkronjat "b" dhe "c" të kësaj pike dhe do të jetë 50% e vlerës së llogaritur"...***

3. Sipas VKM-së nr.414, datë 08.07.2021. "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", dhe VKM-së nr. 290, datë 17.05.2023, "Për një ndryshim në Vendimin nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

Institucionet e qeverisjes vendore, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes civile, përfitojnë çdo vitë nga buxheti qendror një fond të kushtëzuar i cili duhet të ketë destinacion të përcaktuar. Pra referuar nenit 3, citohet se "Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të përdoret sipas prioritizimit, si më poshtë vijon:"

"3.1 60 (gjashtëdhjetë) % – 100 (njëqind) % e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për:
a) ***akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kritereve specifike të përcaktuara në aktet nënligjore që miratohen nga ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41;"***

Për sa është relatuar në paragrafet e mësipërme, nisur nga detyrimet ligjore në fuqi për institucionin tonë, akordimi i fondit sipas vlerës së përcaktuar do të ndihmojë familjet të cilët kanë pësuar dëmtimet nga fatkeqësi në periudha të ndryshme.

Kuader, duke marrë në konsideratë rëndësinë e mbështetjes së menjëhershme dhe të drejtëpërdrejtë për familjet e prekura nga fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi të tjera, si dhe në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, vlerësohet domosdoshmëria e përdorimit të fondit të kushtëzuar për përmbushjen e këtij qëllimi. Akordimi i këtij fondi, në përputhje me parashikimet e nenit 3 të akteve nënligjore që rregullojnë përdorimin e tij, përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm për rimëkëmbjen e banesave të dëmtuara dhe për rikthimin e kushteve të jetesës së sigurt për qytetarët e prekur.

Në përputhje me sa më sipër, dhe duke u bazuar në dokumentacionin verifikues përkatës të përgatitur nga strukturat përgjegjëse vendore dhe të miratuara nga institucionet kompetente qendrore, i propozohet Këshillit Bashkiak miratimi i listës emërore të familjeve të dëmtuara dhe vlerave financiare përkatëse, siç pasqyrohet në tabelën më poshtë. Ky miratim do të mundësojë kalimin në fazën e procedurave financiare për likuidimin e ndihmës ndaj përfituesve, në përputhje me kriteret ligjore dhe financiare në fuqi.

Tabela përmbledhëse për banorët e dëmtuar që përfitojnë nga fondi i emergjencave civile e ndarë si mëposhtë

Nr	Emër Mbiemër	Njësia Administrative	Data e kërkesës	Preventivi për orëndit/endet llogaritur nga KQD	Preventivi për materiale ndërtimi llogaritur nga KQD, në masën 50 % sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012,	Vlera e dëmit totale përfitues
1	Brunilda Bektashi	Nr.3	06.09.2024	547,000	147,834	694,834
2	Sabri Murrizi	Nr.4	19.04.2023	694,000	-	694,000
3	Ibrahim Jaupaj	Nr.4	07.01.2025	513,000	21,794	534,794
4	Lavdrim Kica	Sukthi	04.01.2025	148,549	131,831	280,380
5	Ervis Mehmeti	Nr.6	07.01.2025	280,454	73,475	353,929
6	Dashamir Boshnjaku	Katund I RI	28.05.2025	356,666	147,238	503,904
Total						3,061,841

...te merret nga fondi i kushtëzuar për emergjencat civile, për vitin 2025 i alokuar me
shkresën e Ministrisë së Financave me nr.492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit si dhe
konfirmuar me shkresën e Bashkisë Durrës me nr.2958/1 prot, datë 28.02.25 për kodin e përdorimit
si mëposhtë:

*"Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme"-kodi i
produktit 91707AB.*

Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin tekniko – ligjor, për banesat e dëmtuara nga fatkeqësit si zjarri,
përmbytja, të hartuar nga njësitë administrative respektive si dhe vlerësimin e dëmit me preventivin
me vlerë financiare të hartuar nga Komisioni i Këshillit të Qarkut Durrës.

DREJTOR SHËRBIMEVE PUBLIKE

Ardjan Haxhaj

DREJTOR BUXHETIT

Valbona Qiriako